



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2022:017829
Datë: 17.05.2024
Numri i dokumentit: 05698029

2022:017830

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësit T. Sh.P.K, me seli në rrugën "...", në Ferizaj, me NUI ..., kundër të paditurit G.G., me vendbanim në rrugën e "...", në Ferizaj, me numër personal ..., me objekt kontesti mospërmbushje e kontratës së punës, shpërblimit të dëmit dhe borxhit, me vlerë të kontestit 400.00€, pas mbajtjes së seancës përgaditore me datë 26.04.2024, me datë 17.05.2024 përpiloi me shkrim këtë:

A K T V E N D I M

I. Konsiderohet se është tërhequr padia me shenjë 2022:017830 e paditësit T. Sh.P.K, me seli në rrugën "...", në Ferizaj, kundër të paditurit G.G., me vendbanim në rrugën e "...", në Ferizaj, me objekt kontesti mospërmbushje e kontratës së punës, shpërblimit të dëmit dhe borxhit, me vlerë të kontestit 400.00€.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi, ka ushtruar padi në këtë gjykatë më datë 28.01.2022 kundër të paditurit G.G., me vendbanim në rrugën e "...", në Ferizaj, me objekt kontesti mospërmbushje e kontratës së punës, shpërblimit të dëmit dhe borxhit, me vlerë të kontestit 400.00€.

Gjykata me datë 26.04.2024 ka mbajtur seancën përgaditore, në të cilën ishin të pranishëm i padituri G.G. kurse nuk ishte i pranishëm askush për paditësin edhe pse ishin të ftuar në mënyrë të rregullt sipas fletëkthesës së datës 22.03.2024 ndërsa mungesën nuk e kishin arsyetuar.

Në këtë seancë i padituri kërkoi nga gjykata që të konsiderohet e tërhequr padia e paditësit dhe e njoftoi gjykatën se në muajin mars të vitit 2024 e ka përmbushur obligimin ndaj paditësit në shumën prej 400€.

Andaj gjykata meqenëse paditësi kishte munguar në seancën e datës 26.04.2024 edhe pse ishte ftuar në mënyrë të rregullt, ndërsa mungesën nuk e kishte arsyetuar, nuk kishte kërkuar shtyerjen e seancës, gjykata vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 409.1 të LPK që të konsiderohet e tërhequr padia e paditësit.

Ndërsa gjykata vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 450 të LPK pasi që pala e paditur nuk i kërkoi shpenzimet.

Nga të gjitha të lartë cekurat e konform nenit 142 LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv.

Gjykata Themelore në Ferizaj

Datë 17.05.2024

Gj y q t a r i

Armend Ahmeti

Këshilla juridike: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit, e nëpërmjet të kësaj gjykate.